



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:114379

Datë: 01.08.2024

Numri i dokumentit: 06008346

CP.nr.540/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Gjyqtari Jeton Krasniqi me sekretaren juridike Ajshe Thaqi, në çështjen juridike përmbare të kreditorit S.M nga Komuna e Gllogocit të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.H nga Gllogoci, kundër debitorit Komuna e Gllogocit – Drejtoria e Arsimit, me adresë në Rr. Fehmi e Xhevë Lladrovci, lidhur me kompensimin e kamatës ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare në shumë prej 177.00 euro, duke vendosur në prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit për caktimin e përmbaremit të kësaj gjykate CP.nr.540/23 të dt. 15.08.2023, jashtë seancës gjyqësore me dt.01.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gllogocit për Drejtorinë e Arsimit parashtruar kundër Aktvendimit të kësaj gjykate CP.nr.540/23 të datës 15.08.2023 me të cilin është caktuar përmbaremi i kreditorit S.M nga Komuna e Gllogocit, kundër debitorit, lidhur me kompensimin e kamatës ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme në shumë prej 177.00 euro.
- II. Shfuqizohet** Aktvendimit i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Gllogoc CP.nr.540/23.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Gllogoc me aktvendimin e saj CP.nr. 540/2023 të dt. 15.08.2023, duke vepruar sipas Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Gllogoc C.nr.165/2020 të dt.15.06.2022 ka lejuar propozimin për përmbaremi të kreditorit Komuna e Gllogocit – Drejtoria e Arsimit, me adresë në Rr. Fehmi e Xhevë Lladrovci, lidhur me kompensimin e kamatës ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme në shumë prej 177.00 euro.

Kundër Aktvendimit të kësaj gjykate për caktimin e përmbaremit, debitori ka parashtruar prapësim duke theksuar se kreditori shumë e kërkuar tani më e ka realizuar dhe atë përmes propozimit për përmbaremi të dorëzuar në gjykatë sipas shenjës CP.nr.533/2022 të datës 07.09.2022 në të cilin propozim përveç

borxhit kryesorë ka kërkuar edhe kamatën prej 8% e madje ka bërë edhe llogaritjen e saj duke potencuar decidivisht që “Në emër të borxhit kryesor shumë prej 1,350.00 € me kamatë ligjore 8% në vit nga dita e paraqitjes së padisë apo llogaritur për 29 muaj nga 9 euro në muaj shumë e përgjithshme prej 261 euro së bashku me borxhin kryesor në shumë prej e përbashkët prej 1,611.00 euro. Tutje ka theksuar se për të njëjtën çështje duhet të iniciohet vetëm një procedurë e jo dy procedura ndarazi sepse një formë e tillë po shkakton shpenzime financiare të panevojshme pa fajin e debitorit, andaj ka propozuar që prapësimi i tij të aprovohet si i bazuar, ndërsa aktvendimi i gjykatës me të cilin është lejuar përmbarimi të shfuqizohet.

I autorizuari i kreditorit ka parashtruar përgjigje në prapësim përmes së cilës ka theksuar se debitori ka paraqitur prapësim me pretendime që nuk korrespondojnë me shkaqet prapësimore nga neni 71 i LPP-së të cilat janë taksativisht apo nuk mundë të ketë shkaqe tjera duke pasur parasysh natyrën rigorozë formale të procedurës përmbarimore edhe pse pretendimet e debitorit janë të pa bazuara. Tutje ka theksuar se nuk mundë të pajtohet me këtë qëndrim sepse vetëm fakti se në një procedurë tjetër është lejuar përmbarimi nuk do të thotë se më në kurrfarë rrethane nuk mundë të paraqitet propozim për të njëjtën kërkesë. Tutje ka theksuar se siç shihet nga deklaratimet e palës debitore nuk kundërshtohet fakti se kreditori ende nuk e ka realizuar kërkesën e kamatës por vetëm borxhin kryesor. Dhe se i njëjti është i obliguar që ta paguaj kamatën nga data 04.03.2020 e deri në ditën e realizimit të borxhit kryesor meqë borxhi kryesor është realizuar me datë 20.07.2023 atëherë kreditori me të drejtë ka kërkuar përmbarimin e kamatës nga dita e parashtrimit të padisë me 28.02.2020 e deri më 20.07.2023, andaj gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar ndërsa aktvendimin e gjykatës ta lë në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim si dhe thëniet e kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe atë për këto arsye.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar për përmbarimin e dokumentit përmbarimor – aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Glllogoc C.nr.165/2020 të dt.15.06.2022, për shkak të kamatës së pa paguar në normën prej 8 % nga periudha 28.02.2020 e deri më 18.05.2023, i cili propozim është lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.540/2023 të datës 07.09.2022.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmban dokumenti i përmbarimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarim të dokumentit përmbarues, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit në bazë të dokumentit përmbarues janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të nenit 21, 22, 27 dhe 38 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin përmbarimor-aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Glllogoc C.nr.165/2020 të dt. 15.06.2022.

Gjykata pasi që e ka shqyrtuar prapësimin e debitorit, përgjigjen në prapësim të kreditorit dhe pasi që i ka analizuar shkresat e lëndës ka gjetur se lidhur me çështjen e njëjtë, kreditori ka iniciuar dy procedura përmbarimore. Fillimisht me datë 09.08.2022, kreditori ka parashtruar propozim për përmbarim për borxhin kryesor në shumë prej 1,350.00 €, kamatën prej 8% në shumë prej 261 € (nga data e paraqitjes së padisë 28.02.2020 deri në ditën e parashtrimit të propozimit me datë 09.08.2022, gjithsej 29 muaj), taksën gjyqësore për propozim prej 30 €, shpenzimet e procedurës kontesti morë në shumë prej 269 €, për propozim për përmbarim shumë prej 156 €, taksën gjyqësore për propozim 31 €, apo shumë e përgjithshme prej 2,067.00 €. Pastaj kreditori me datë 22.05.2023 paraqet propozim të ri për përmbarim

mbi bazën e aktgjykimit të njëjtë të cekur si më lartë lidhur me kamatën e pa paguar për periudhën 28.02.2020 deri më 18.05.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi caktimin e përmbarimit CP.nr.540/2023 i datës 07.09.2022, ishte bërë i formës së prerë, gjyqtari i çështjes me aktvendimin CP.nr.533/22 të datës 19.01.2023 kishte urdhëruar Ministrinë e Financave –Departamenti i Thesarit që të transferoj në llogari të të autorizuarit të kreditorit shumën prej 1,806 euro dhe atë për kompensimin shujtave ditore në shumën prej 1,350 euro, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 269 euro, propozimin për përmbarim në shumën prej 156 € dhe taksën gjyqësore për propozim në shumën prej 31 euro por nuk ishte urdhëruar që të ekzekutohet edhe shuma prej 261 euro në emër të kamatës.

Gjyqtari i çështjes pasi që i ka analizuar shkresat e të dy lëndëve CP.nr.533/22 dhe ato të lëndës CP.nr.540/23 ka gjetur se kërkesa e kreditorit lidhur me kamatën për një periudhë është çështje e gjykuar (res judicata) dhe atë për periudhën prej 28.02.2020 e deri më 09.08.2022 në shumën prej 261 euro) e lejuar me aktvendimin CP.nr.533/22 të dt. 07.09.2022, ndërsa nga periudha e prej 28.02.2020 e deri më 18.05.2023 të kërkuar sipas propozimit të datës 22.05.2023 dhe të lejuar me aktvendimin e datës 15.08.2023, gjykata gjenë se për periudhën 10.08.2022 e deri më 18.05.2023, nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar por për këtë periudhë aktvendimi i Gjykatës CP.nr.540/23 i datës 15.08.2023 nuk është i përmbarueshëm në kuptim të nenit 71 par.1.1 sepse me këtë aktvendim është lejuar propozimi për përmbarim i kreditorit për kamatën ku është cekur vetëm periudha por jo edhe shuma e kamatës.

Andaj, meqenëse kreditori në përgjigjen në prapësim ka theksuar se kjo çështje është përfunduar, e cila vërtetohet edhe me fletë pagesën e lartcekur, gjykata në bazë të nenit 73 par 3të LPP, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
CP.nr.540/2023 datë 01.08.2024

Gj y q t a r i,
Jeton Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga pranimi i të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.